



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

**Kodi i lëndës: INF 472**  
**Lënda: Infermieri Pediatrike**

PROGRAMI I LËNDËS Infermieri Pediatrike									
Titullari i lëndës:		Rezarta Lalo <i>Dr. në Shkencat Infermierore</i>							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
	12 ECTS	Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total	165	300
Tipologjia e lëndës		Lëndë karakterizuese B							
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri II							
Lloji i lëndës		E detyruar							
Programi i studimit		Master Profesional ne Infermieri Pediatrike.							
Kodi i lëndës		INF 472							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		<a href="mailto:rezarta.petani@univlora.edu.al">rezarta.petani@univlora.edu.al</a>							

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**

<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në këtë modul studentëve u ofrohet mundësia për të rritur kapacitetet në fushën e kujdesit infermieror perinatal, në ndjekjen e zhvillimit të fëmijës dhe kujdesit infermieror në patologjitë pediatrike. Integrimi i praktikimit të teknikave të reja infermierore, i zgjerimit të koncepteve për stadet e zhvillimit human, i pat-fiziologjisë, i menaxhimit mjekësor e infermieror në planet e asistencës infermierore që kanë në qendër kujdesin për pacientin, u japin mundësi studentëve me formim infermieror të përgjithshëm të masterizojnë kapacitetin e tyre profesional si infermierë peditër.</p>
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Njohja me ekzaminimin fillestar dhe të plotë të neonatit në term.</li><li>Të vlerësohet kujdesi infermieror për neonatin me veshtirësi respiratore dhe teknikat e reanimimit neonatal</li><li>Të vlerësohet kujdesi për problematika dhe komplikacione pas lindjes tek foshnja e porsalindur</li><li>Të vlerësohet ushqyerja me gji dhe problemet e ushqyerjes tek i porsalinduri</li><li>Njohja e procesit infermieror, marrjes së anamnezës dhe ekzaminimit fizik në pediatri.</li><li>Njohja me patologjitë e fëmijës sipas trakteve dhe sistemeve të organizmit dhe planet e asistencës infermierore në secilin rast.</li><li>Të vlerësohet planifikimi, implementimi i kujdesit sipas diagnozave infermierore në çdo patologji pediatrike si edhe edukimi shëndetësor i fëmijës dhe familjarëve të tij.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p><i>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>Të përvetësojnë teknikat infermierore bashkëkohore të kujdesit perinatal.</li><li>Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të rritjes së fëmijëve dhe kujdesit perinatal</li><li>Të hartojnë dhe zbatojnë planet e personalizuar të asistencës infermierore në patologjitë kryesore pediatrike.</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit infermieror të pacientëve adultë fëmijë me patologji pediatrike</li><li>▪ Të njohin dhe aplikojnë teknikat infermiere më të avancuar atë kohës.</li><li>▪ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit infermieror në fushën e patologjive pediatrike.</li><li>☞ Të formojnë shprehi për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime ndërhyrje në sistem.</li></ul>
--	--

### KONCEPTET THEMELORE

1. Koncepti i kujdesit perinatal dhe menaxhimit të rritjes dhe zhvillimit të fëmijës
2. Koncepti i procesit infermieror, hallkat dhe implementimi i tij në pediatri
3. Implementimi i planeve të kujdesit infermieristik në patologji të sistemeve të ndryshme të organizmit të fëmijës
4. Konsiderata speciale në shëndetin e fëmijës në lidhje me deficiencat e sjelljes, inteligjencës së fëmijës dhe formave të abuzimit ndaj tij.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<b>Tema 1</b> -Vleresimi i mireqenies fetale. Kujdesi infermieror gjatë vuajtjes fetale <i>Ekzaminimet biometrike dhe biofizike, vleresimi i ëvizjet fetale dhe dëgjimi i rrahjet e zemres M onitorimi elektronik i RZF dhe percaktimi i Ph te gjakut jane 2 nga metodat percaktuese te distresit fetal intrauterin.</i>	<i>fq 20-25</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 2</b> - Kujdesi prenatal per parandalimin e lindjeve IUGR/SGA. <i>IUG dhe SGA dhe menytrat e zbulimit te hershem nepermjet grafikeve te rritjes intrauterine, identifikimit te faktoreve te riskut si per nene ashtu edhe per fetusin me qellim promovimin e shendetit per parandalimin e tyre.</i>	<i>fq.25 - 34</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 3</b> -Vleresimi i shpejte fillestar i te porsalindurit dhe parimet e kujdesit neonatal. Detyrat e infermieres ne sallën e lindjes. <i>Nepermjet ketij leksioni studentet mesojne hapat baze te kujdesit ndaj te porsalindurit, si te pergatisin nje dhome te sigurte dhe te ngrohte per cdo lindje, te zbatojne zinxhirin e ngrohte dhe te respektojne masat universale per te parandaluar infeksionin. Gjithashtu mund te vleresojne gjendjen e te porsalindurit ne lindje dhe kujdesin gjate 2 oreve te para te jetes. Fq 191-205.</i>	<i>fq.191-205</i>	Leksion 1 orë
	<b>Praktike 1:</b> Monitorimi elektronik i vazhduar i RZF. Teknikat e monitorimit elektronik të RZF <b>Praktike 2:</b> Përdorimi i kurbave të rritjes intrauterine. <b>Praktike 3:</b> Parandalimi i infeksionit tek foshnja e porsalindur		Praktikë 6 orë
II.	<b>Tema 4</b> - Kujdesi infermieror gjate ekzaminimit te plote klinik te neonatit ne term. <i>Nepermjet ketij leksioni studentet do te jene ne gjendje te realizojne nje ekzaminim te plote te te porsalindurit qe perfshin te gjitha sistemet e organizmit ne menyre qe te identifikojne cdo shenje rreziku, cdo difekt ose traume si edhe te vleresojne pershtatjet normale te tij pas lindjes.</i>	<i>fq.206 - 219</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 5</b> -Foshnja me peshe te vogel ne lindje/kujdesi dhe ushqyerja e tij. <i>Kujdesi per foshnjat e vogla ne shumicen e rasteve nuk kerkon aparatura mjekesore te shtrenjta por nje kujdes te thjeshte si ushqyerja me gj, qendrimi ne nje dhome me nenen dhe Kujdesi Kangur. Menaxhimi infermieror per parandalimin e hypotermise, teknikat e ushqyerjes me gj dhe alternative si edhe parandalimi i hypoglicemise</i>	<i>fq.220 - 241</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>jane ne fokus te ketij leksioni.</i></p> <p><b>Tema 6</b> - Kujdesi infermieror gjate dhe pas reanimacionit neonatal. <i>Pritja, pergatitja e mjaftueshme, vleresimi i sakte dhe fillimi i menjehershem i mbeshtetjes jane kritike per reanimacionin e suksesshem neonatal. Nepermjet ketij leksioni studenti do te jete ne gjendje te beje vleresimin fillestar per te vendosur kur te filloje reanimacionin, te njohe pajisjet dhe tekniken e reanimimit nepermjet ciklit te vazhdueshem Vlereso-Klasifiko-Menaxho.. E rendesishme eshte gjithashtu monitorimi dhe vleresimi i te porsalindurit pas reanimimit per komplikacione te mundshme si menaxhimi i konvulzioneve, veshtiresive te frymemarrjes, mbajtjes se hemodinamikes, nxitjes se ushqyerjes.</i></p> <p><b>Praktike 4:</b>Zbatimi i hapave bazë të kujdesit ndaj të porsalindurit. Zbatimi i zinxhirit të ngrohtë. Veshja e të porsalindurit</p> <p><b>Praktike 5:</b>Metodat për ngrohjen e foshnjës dhe mbajtjen e temperaturës trupore. Inkubatori. Ngrohësja rrezatuese.Metoda e Kujdesit Kangur tek foshnjat e vogla, metodat e parandalimit te hypotermisë dhe metodat e ushqyerjes së foshnjes SGA, prematur</p> <p><b>Praktike 6:</b>Teknikat e reanimimit neonatal. Ventilimi me qese dhe maskë. Kompzimimi i kraharorit.Intubimi endotrakeal. Studim rasti për parimet bazë të menaxhimit të të porsalindurit të reanimuar</p>	<p><i>fq.242 - 272</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktike 6 orw</p>
	<p><b>Tema 7</b> -Identifikimi dhe kujdesi infermieror per neonatin me distres respirator <i>Vleresimi i shkaqeve dhe shenjave te distresit respirator si edhe nderhyrjet e duhura te emergjences si permiresimi i shpernsdarjes se oksigjenit, furnizimit me gjak te mushkerive, trajtimit te acidozes respiratore dhe metabolikejane objektivat infermiore te ketij leksioni.</i></p> <p><b>Tema 8</b> -Klasifikimi i veshtiresive te frymemarrjes dhe menaxhimi infermieror i tyre tek foshnjat e porsalindura. <i>Vleresimi i shenjave klinike te veshtiresive respiratore, klasifikimi i gravitetit dhe metodat e reanimimit sipas shkalles perbejne planin e kujdesit ne raste te tilla. Gjithashtu mesohen metodat e administrimit te oksigjenit si edhe monitorimi i reagimit te foshnjes ndaj oksigjenit.</i></p> <p><b>Tema 9</b> -Administrimi dhe monitorimi i O<sub>2</sub> per te porsalindurin e semure dhe ne risk <i>Ky leksion trajton identifikimin e femijeve qe kane nevojë per oksigjen suplementar, te monitorojne oksigjenimin e bebit dhe dhe administrimin e oksigjenit duke kuptuar avantazhet dhe rreziqet e tij.</i></p> <p><b>Praktike 7:</b>Transiluminimi dhe rrezet X të kraharorit. Aspirimi me gjilpërë i PNX. Insetimi i tubit të kraharorit</p> <p><b>Praktike 8:</b>Matja e përqendrimit të O<sub>2</sub>. Ngrohja dhe lagështimi i përzierjes O<sub>2</sub>/ajër. Përdorimi i pulsoximetrit.</p> <p><b>Praktike 9:</b>Matja e gazeve në gjakun arterial periferik.Metodat e administrimit te O<sub>2</sub> me kanul nazale, kateter nazal, kutia e oksigjenit.Llogarisni rrjedhjen dhe perqendrimin e O<sub>2</sub> gjate administrimit te tij me kete metode.</p>	<p><i>fq.274 - 281</i></p> <p><i>fq.282 - 298</i></p> <p><i>fq. 299 - 310</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
III.			
IV.	<p><b>Tema 10</b> -Ikteri tek i porsalinduri. Kujdesi infermieror <i>Dallimi i ikterit fiziologjik dhe patologjik, hapat kryesore te menaxhimit te te porsalindurit me ikter nepermjet teknikes se fototerapise perbejne</i></p>	<p><i>fq. 311 - 326</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>nderhyrjet kryesore infermiore ne kete leksion.</i></p> <p><b>Tema 11</b> -Infeksionet neonatale bakteriale. Kujdesi infermior. <i>Infeksionet neonatale mund te jene lokale, me vater dhe te gjeneralizuar si sepsisi neonatal qe kerkojne njohjen e shenjave specifike, metodat e ekzaminimit dhe menaxhimin infermior sipas klasifikimit dhe shkaktarit. E rendesishme eshte parandalimi i faktoreve riskues, parandalimi i infeksioneve nozokomiale ne maternitet si edhe teknika e administrimit te antibiotikeve nga infermierja.</i></p> <p><b>Tema 12</b> -Konvulzionet dhe spazmat tek neonati. Kujdesi infermior <i>Vecorite dalluese te konvulzioneve dhe spazmave si edhe vleresimi i faktoreve etiologjike ndihmojne infermierin ne percaktimin e diagnozave infermiore dhe nderhyrjeve perkatese per foshnjat qe ekspozohen ndaj ketyre anomalive te keqfunksionimit te sistemit elektrocerebral.</i></p> <p><b>Praktike 10:</b>Teknika e fototerapisë <b>Praktike 11:</b>Inserimi dhe menaxhimi i kateterit umbilikal. Kryerja e punkturës lumbare. Antibiotikët që përdoren për mjekimin e infeksioneve bakteriale, mënyra e administrimit nga infermierja <b>Praktike 12:</b>Ndihma infermiore në parandalimin e dëmtimeve tek fëmija me konvulziona, menaxhimi infermior i fëmijes gjatë konvulzioneve.</p>	<p><i>fq.334 - 369</i></p> <p><i>fq.370 - 378</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>
V.	<p><b>Tema 13</b> -Kujdesi infermior per foshnjat me dehidrim. <i>Te vjellat, diarrea, fryrja e barkut jane simptomat kryesore te diagnozave te mundshme qe sjellin si pasoje dehidrimin e foshnjave te porsalindura. Bazuar mbi nje vleresim te kujdesshem infermior nepermjet anamnezës dhe ekzaminimeve percaktohen problemet potenciale te shendetit qe konsiderohen diagnoza infermiore dhe planet infermiore te implementuara per foshnjat me dehidrim.</i></p> <p><b>Tema 14</b> -Ushqyerja me gji dhe crregullimet e saj. Kujdesi dhe edukimi shendetesor. <i>Vleresohet rendesia e ushqyerjes me gji, pozicionet korrekte dhe teknikat e keshillimit. Implementimi i formularit te teknikes se thithjes e rekomnduar nga OBSH dhe zbatimi i tij ne praktike ndihmon si nje mjet per monitorimin dhe identifikimin e hershem te crregullimeve te ushqyerjes me gji dhe nderhyrjet infermiore ne lezionet e gjirit dhe permiresimin e teknikes se dhenies se gjirit.</i></p> <p><b>Tema 15</b> -Ushqyerja e perzier, me taje dhe artificiale. Kujdesi infermior. <i>Kur qumeshti i nenes eshte i pamjaftueshem atehere ai plotesohet se zevendesohet plotesisht me qumesht tjeter (me mire farmacie). Ne kete leksion pasqyrohen qarte udhezimet per pergatitjen e qumeshtit, sasia dhe vaktet sipas moshës, njohja e perberesve te qumeshtit te lopes duke e krahasuar me vlerat e qumeshtit te nenes si qumesht i pazevendesueshem me impakt pozitiv ne rritjen e shendetshme te femijes dhe forcimit te imunitetit te tij.</i></p> <p><b>Praktike 13:</b>Teknikat e rehidrimit te foshnjes me diarre, te vjella.Teknika e kryerjes se injeksioneve IM, SC, intradermale, infuzioni intraoseal, transfuzioni i gjakut dhe infuzionet venoze periferike.</p>	<p><i>fq.379 - 387</i></p> <p><i>fq. 401 -415</i></p> <p><i>fq.418 - 425</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Praktikë 6 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies	
	<p><b>Praktike 14:</b>Teknika e ushqyerjes me gji tek të porsalindurit, ushqyerja me luge dhe gote. Implementimi i formularit të teknikes se thithjes ne identifikimin e veshitresive te ushqyerjes me gji.</p> <p><b>Praktike 15:</b>Përgatitja e ushqimit sipas muajve për fëmijët që ushqehen artificialisht dhe me ushqyerje të përzier. Teknika e ushqyerjes me tub nazogastrik</p>			
VI.	<p><b>Tema 16-</b>Proçesi infermieror,anamneza infermiore në pediatri. <i>Procesi infermieror si nje metode sistematike per te kryer veprime infermiore te pavarura ka shume benefite, pasi lejon aplikimin e njohurive dhe aftesive te infermierit ne menyre te organizuar. Fazat e tij si vleresimi, formulimi i diagnozes infermiore, identifikimi i rezultateve, plani dhe zbatimi i nderhyrjevevleresimi i efektivitetit te planit i aftesojne infermieret qe ti inkorporojne keto koncepte ne praktiken klinike.</i></p> <p><b>Tema 17 -</b> Kontrolli fizik dhe testet laboratorike në pediatri.Testi ASQ-3 <i>Niveli i zhvillimit te femijes eshte konsideruar shume i rendesishem per nje vleresim te suksesshem ku cdo vizite dhe kontroll shendetesor sherben si nje eksperience mesimi per prindin dhe femijen. Roli i infermierit ne identifikimin e problemeve shendetesore por edhe ne lidhje me zhvillimin fizik dhe mendor te femijes eshte eshte padyshim kyc per per depistimin dhe parandalimin e hershem te tyre.</i></p> <p><b>Tema 18 -</b>Kujdesi infermieror në sëmundjet e syrit, veshit <i>Trajtohen crregullime te syrit si ambliopia, strabizmi apo infeksioni me i shpeshte i syrit si konjuktiviti duke implementuar bazuar ne diagnozat infermiore planet e kujdesit dhe testet e diagnostikimit te tyre. Gjithashtu trajtohen problemet e demtimit te degjimit dhe inflamacionit me te shpeshte te veshit te mesem, otitis media. Edukimi shendetesor i prinderve dhe femijeve mbi masat parandaluese dhe metodave te instalimit te medikamenteve ne sy dhe ne vesh eshte nje tjeter hallke e kujdesit te infermierit me perfitime afatgjate ne shendetin e femijes.</i></p> <p><b>Praktike 16:</b> Administrimi i proçesit infermieror. Marrja e anamnezës në pediatri. Plotesimi i karteles infermiore.</p> <p><b>Praktike17:</b>Aplikimi i testit ASQ-3</p> <p><b>Praktike 18:</b> Aplikimi i testeve diagnostikuese tek fëmijët me strabizëm. Instalimi i medikamenteve në mukozën e syrit dhe veshit.</p>	<p><i>fq. 445 - 451</i></p> <p><i>fq.451 - 465</i></p> <p><i>fq.466 - 473</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 6 orë</i></p>	
	VII.	<p><b>Tema 19 -</b> Kujdesi infermieror në sëmundjet e hundës dhe fytit <i>Crregullimet me te zakonshme te femijerise, kryesisht te moshes 4-7 vjec, tonsillitis dhe pharingitis jane inflamacione te fyrit kryesisht me origjine virale por edhe bakteriale qe kerkojne asistence infermiore dhe edukim shendetesor per parandalimin e komplikacioneve si ethja reumatizmale apo glomerulonefriti. Kultura e fytit, trajtimi dietetik per lehtesimin e simptomave dhe rendesia e perfundimit te kures se plote me antibiotik ne rast infeksioni bakterial perbejne edhe ceshtjet kyce te kujdesit ndaj ketyre problemeve.</i></p> <p><b>Tema 20 -</b> Kujdesi infermieror në sistemin respirator tek fëmijët: dysplazia bronkopulmonare,laringotrakeobronkiti akut (LTB).</p>	<p><i>fq. 473 - 478</i></p> <p><i>fq.479 - 484</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Metodat e fizioterapise se kraharorit dhe instruksionet pas daljes nga spitali per nje femije me tracheostomi perbejne thelbin e edukimit shendetesor per femijet me semundje kronike obstruktive pulmonare qe ndodh kryesisht nga terapia e zgjatur me O2, ku te predispozuar jane femijet premature. Monitorimi i statusit respirator, masat per ambjent te fresket dhe te lagesht, masat e konfortit per femijen me qellim pakesimin e stresit te tij perbejne edhe kujdesjet kryesore tek femijet me LTB.</i></p> <p><b>Tema 21-</b> Kujdesi infermieror në sistemin respirator tek fëmijet: epiglotiti, aspirimi i trupave të huaj</p> <p><i>Inflamacioni dhe enjtja e epiglotit me pasoje bllokimin e rrugeve respiratore kerkon asistencë infermiere te kualifikuar ne drejtim te implementimit te metodave te oksigjenimit te femijes, intubimit endotrakeal, por edhe menjanimet te stimulit direkt te rrugeve respiratore qe provokon spazmat jane efikase ne trajtimin e femijeve me epiglotit. Gjithashtu njohja e metodes Heim lich per lirimin e rrugeve respiratore nga trupi i huaj perben edhe thelbin e ndihmes se pare tek femijet qe pesojne inhalacion te objekteve ne traktin respirator.</i></p> <p><b>Praktike 19:</b> Zbatimi i procesit dhe kujdesit infermieror tek fëmijët me patologji hundës, fytit. Studim rastesh. Instalimi i medikamenteve ne mukozen e hundes, fytit</p> <p><b>Praktike 20:</b> Aplikimi i teknikës së fizioterapisë së kraharorit tek fëmijët</p> <p><b>Praktike 21:</b> Aplimi i metodave per nxjerrjen e trupit te huaj nga trakti respirator</p>	<p><i>fq.484 - 494</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 6 orë</i></p>
III.	<p><b>Tema 22 -</b> Kujdesi infermieror në sistemin respirator tek fëmijët: bronkioliti, pneumonia</p> <p><i>Inflamacioni i bronkiolave dhe pulmoneve qe karakterizohet nga demtimi i shkembimit gazor ka ne fokus monitorimin e simptomave respiratore por edhe problemet e irritabilitetit, lodhjes nga hypoksia, veshitresise ne ushqyerje apo temperatures se larte. Aplikimi i metodave PVD, masave per uljen e temperatures dhe parandalimit te perhapjes se infeksionit perbejne kujdesjet kryesore tek femijet me pneumoni dhe bronkiolit.</i></p> <p><b>Tema 23 -</b> Kujdesi infermieror në sistemin respirator tek fëmijët: astma bronkiale, fibroza cistike.</p> <p><i>Parandalimi i faktoreve qe shkaktone bronkospazmat si shkaktare te astmes qe konsiderohet nje proces i rikthyeshem i ngushtimit te rrugeve respiratore perben fokusin kryesor te kujdesit infermieror. Gjithashtu aplikimi i fizioterapise se kraharorit, administrimi i vitaminave dhe enzimeve pankreatike si dhe respektimi i nje diete hipekalorike perbejne kujdesin per nje femije me fibroze cistike, nje semundje e trashëguar autozomale recesive.</i></p> <p><b>Tema 24 -</b> Problemet në sistemin kardiak tek fëmijët. Difektet cianotike dhe acianotike të zemrës</p> <p><i>Difektet e septumit atrial, ventrikular dhe koarktacio aorte perbejne edhe difektet acianotike te zemres qe kerkojne nderhyrje kirurgjikale por edhe kujdes infermieror ne lidhje me ankthin, riskut per demtim te rritjes dhe zhvillimit te femijes dhe mbi te gjitha demtimin te shkembimit te gazeve dhe riskut per infeksion. Shunti nga e djathta ne te majte ose difektet cianotike kerkojne nje vleresim infermieristik ne lidhje me krizat hypercyanotike. Kirurgjia korrigjuese por edhe nderhyrjet paliative per</i></p>	<p><i>fq. 494 - 506</i></p> <p><i>fq.507 - 518</i></p> <p><i>fq.519 - 526</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies	
	<p><i>permiresimin e oksigjenimit dhe perfuzionit te demtuar kardiopulmonar perbejne thelbin e trajtimit te femijeve me keto probleme.</i></p> <p><b>Praktike 22:</b>Administrimi i antibiotikëve në pediatri. <b>Praktike 23:</b> Perdorimi i Peak Flow Meter tek femija me astma bronkiale. Teknika e spirometrise. <b>Praktike 24:</b>Zbatimi i procesit dhe kujdesit infermieror tek fëmijët me probleme kardiake. Studim rastesh. Monitorim dhe matja e parametrave vitalë të fëmijëve</p>		<i>Praktikë 6 orë</i>	
IX.	<p><b>Tema 25</b> -Problemet e sistemit nervor tek fëmija. Kujdesi infermieror tek fëmijët me konvulziona. <i>Keqfunksionime te aktivitetit elektrik te truritqe shkaktone konvulzionet tek femijet me etiologji idiopatike por te favorizuar nga hypoksia perinatale, infeksione te ndryshme apo semundje metabolike kerkojne implementimin nga infermierja te metodave mbrojtese ndaj femijes gjat konvulzionit si edhe promovimit te imazhit pozitiv te femijeste cilet mund te vuajne edhe nga vetvleresimi i ulet apo deshtimi akademik.</i></p> <p><b>Tema 26</b> - Problemet e sistemit nervor fëmijëve. Kujdesi infermieror tek fëmijët me trauma, fraktura,kontuzione, komocione <i>Njohja me llojet dhe kategorite e ndryshme te traumave te kokes me pasoje rritjen e presionit intrakranial identifikon nevojën e monitorimit te shenjave neurologjike te femijes, rehabilitimit te tij duke kombinuar terapine fizike dhe okupacionale.</i></p> <p><b>Tema 27</b> - Problemet e sistemit nervor tek fëmija. Kujdesi infermieror tek fëmijët me meningit <i>Vleresimi i gjendjes neurologjike, masat paraprake kunder krizave konvulzive dhe kujdesi per hypertermine i shkaktuar nga infeksioni perbejne nderhyrjet kryesore tek femija me meningit. Gjithashtu vleresimi i proves Brudzinski pozitiv, simptomes Kernig perben vleresimin infermieror te simptomave kryesore qe lidhen me meningitin.</i></p> <p><b>Praktike 25:</b>Njohja me Shkallen Glasgow te komes dhe testet e tjera diagnostikuese ne vleresimin e SN te femijes <b>Praktike 26:</b>Teknika e EEG tek fëmijët <b>Praktike 27:</b>Praktikimi për vlerësimin e shenjave meningeale tek fëmijët.Teknika e punktures lumbare tek femijet.</p>	<p><i>fq. 527 - 529</i></p> <p><i>fq.529 - 533</i></p> <p><i>fq. 534 - 536</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>	
	X.	<p><b>Tema 28</b> - Problemet e sistemit renal tek fëmijët. Kujdesi infermieror në IRA, IRK, infeksionin urinar. <i>Njohja me terapine e zevendesimit renal dhe asistencen e infermierit gjate implementimit te tij perben thelbin e trajtimit te femijeve me IRA dhe IRK. Gjithashtu edukimi i femijes dhe familjes ne lidhje me parandalimin e infeksionit urinar sidomos ne inkurajimin per boshatisjen e fshikezes dhe lengjeve acidifikuese te urines per ben fokusin e kujdesit ndaj femijeve me infeksion urinar.</i></p> <p><b>Tema 29</b> - Problemet e sistemit renal tek fëmijët. Kujdesi infermieror në glomerulonefrit akut,sindromin nefrotik. <i>Mbajtja e nje presioni normal te gjakut, diurezes normale dhe ruajtjes se lekures nga demtimet per shkak te edemes jane objektivat kryesore te kujdesit bazuar ne diagnozat infermiore.Gjithashtu kujdesi per ushqyerjen e femijes duke kufizuar Na dhe proteinat ne fazen edematoze eshte nje tjetër aspekt qe duhet vleresuar tek femijet me problemet e mesiperme renale.</i></p>	<p><i>fq.537- 545</i></p> <p><i>fq. 545 - 552</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies	
	<p><b>Tema 30</b> - Problemet e sistemit endokrin tek fëmijët. Kujdesi infermieror në hipotiroidizëm, hipertiroidizëm <i>Administrimi i kujdeshem i terapise se zevendesimit te hormoneve ne rastin e hypotiroidizmit apo uljes se sekretimit te tyre ne rastin e hipertiroidizmit, keshillimi gjenetik, trajtimin dietetik dhe edukimi pre dhe postoperator ne rast nderhyrje kirurgjikale perbejne fokusin e kujdesjeve tek femijet me probleme te gjendres tiroide.</i></p> <p><b>Praktike 28:</b> Teknika e kryerjes se Hemodializes dhe Dializes peritoneale <b>Praktike 29:</b> Teknika e matjes se TA tek femijet. Administrimi i antibiotikëve në pediatri. <b>Praktike 30:</b>Zbatimi i procesit dhe kujdesit infermieror tek fëmijët me patologji të tiroides. Studim rastesh.</p>	<p><i>fq. 553 - 555</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 6 orë</i></p>	
XI.	<p><b>Tema 31</b> - Problemet e sistemit endokrin tek fëmijët. Kujdesi infermieror në diabet mellitus. <i>Vleresimi infermieristik i shenjave te hyperglicemise, hypoglicemise dhe ndihma infermiore ne raste te tilla perben thelbin e kujdesit tek femijet me diabet. Gjithashtu theksohet rendesia e zbatimit te dietes dhe menyres se ushqyerjes te ketyre femijeve.</i></p> <p><b>Tema 32</b> - Problemet e sistemit muskuloskeletik tek fëmijët. Kujdesi infermieror në distrofinë muskulare <i>Ky grup crregullimesh qe karakterizohet nga degjenerimi progresiv i muskujve skeletike ka ne fokus te kujdesit terapine fizike dhe kontrollin e infeksioneve.</i></p> <p><b>Tema 33</b> - Sëmundjet e lëkurës tek fëmijët. Kujdesi infermieror në ekzema. <i>Ekzema si nje inflamacionsiperfaqesor i lekures me tendenca trashegimieshfaqet me teper tek femijet qe kane alergji dhe karakterizohet nga kruajtje te forta qe kerkojne nje kujdes efikas te lekures per ta mbrojtur nga tharja, infeksioni dhe faktoret alergizues.</i></p> <p><b>Praktike 31:</b>Administrimi i injeksioneve të insulinës tek fëmijët me diabet mellitus. Matja e kurbës së glicemisë. Përdorimi i glukometrit <b>Praktike 32:</b>Teknikat e terapise fizike tek femijet me distrofi muskulare. <b>Praktike 33:</b> Zbatimi i procesit dhe kujdesit infermieror tek fëmijët me patologji të lëkurës. Studim rastesh</p>	<p><i>fq. 557 - 562</i></p> <p><i>fq. 563 - 565</i></p> <p><i>fq 566 - 568</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 6 orë</i></p>	
	XII.	<p><b>Tema 34</b> - Problemet e sistemit imunitar tek fëmijët. Kujdesi infermieror ne TORCH, në sëmundjet infektive të fëmijërisë <i>Semundje qe lejojne ekspozimin fetal nepermjet placentes dhe qe kerkojne kujdesin fizik, ushqyerjen, vecimin e femijes, parandalimin e komplikacioneve dhe demtimeve kongenitale. Theksohet nevoja per vaksinim si mase parandaluese dhe mbrojtese e imunitetit te femijes.</i></p> <p><b>Tema 35</b> - Problemet e sistemit imunitar tek fëmijët. Kujdesi infermieror në sindromin e SIDA tek fëmijët. <i>Vleresohen rruget e transmetimit dhe menyra e parandalimit te ketij infeksioni qe kkk nga ulja e imunitetit ndaj infeksioneve te ndryshme.</i></p> <p><b>Tema 36</b> - Problemet në sistemin qelizor të fëmijëve. Kujdesi infermieror në leukoza. <i>Kanceri i indeve qe formojne gjakun ku faktori gjenetik ka rol ne incidencen e saj. Edukimi shendetesor dhe nderhyrjet sipas diagnozave</i></p>	<p><i>fq. 569 - 573</i></p> <p><i>fq. 573 - 576</i></p> <p><i>fq.577 - 581</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>infirmierore jane te rendesishme per parandalimin e infeksionit, te demtimit te lekures dhe mukozave nga risku i hemorragjise si dhe mbeshitetjes emocionale ne rastet e demtimit te imazhit trupor nga efektet e kimioterapise.</i></p> <p><b>Praktike 34:</b> Njohja me kalendarin e vaksinimit te femijeve. Studim rastesh ne praktiken klinike te femijeve me semundje infektive si fruthi, rubeola.</p> <p><b>Praktike 35:</b> Studim rastesh ne praktiken klinike te femijeve me semundje infektive si parotiti, varicela.</p> <p><b>Praktike 36:</b> Administrimi i terapise profilaktike dhe kimioterapise tek femijet me leukoza</p>		Praktikë 6 orë
III.	<p><b>Tema 37</b> - Problemet në sistemin gastrointestinal tek fëmijët. Kujdesi infermieror në frenimin e rritjes dhe hepatit. <i>Ne fokus te kesaj teme eshte njohja e studenteve me faktoret riskues qe shkaktojne frenimin organik dhe jo organik te rritjes ne te cilin pesha e femijes bie nen vlerat normale sipas tabelës së standartizuar te rritjes dhe roli i infermierit per nje ushqyerje te shendetshme eshte pa diskutim i domosdoshem ne trajtimin dhe parandalimin e ketij fenomeni. Njohja me rruget e transmetimit te hepatiti, kujdesit per ekuilibrin hidro-elektrolitik, menaxhimit te dhimbjes nga demtimi i heparit dhe rendesia e parandalimit perfshire vaksinimin ne moshat femijerore.</i></p> <p><b>Tema 38</b> - Problemet e sistemit hematologjik të fëmijëve. Kujdesi infermieror në talasemi. <i>Crrregullim i sintezes se Hb qe karakterizohet me anemi dhe kerkon administrimin e produkteve te gjakut, terapise per eliminimine Fe dhe kujdes infermieror per parandalimin e komplikacioneve, demtimeve te mundshme dhe shqetesimeve te imazhit trupor.</i></p>	fq. 582 - 587	Leksion 1 orë
	<p><b>Tema 39</b> - Problemet e sistemit hematologjik të fëmijëve. Kujdesi infermieror në aneminë ferriprive. <i>Anemia me e zakonshme e femijerise e lidhur me ushqyerjen e femijes, por edhe nga humbja kronike e gjakut. Modifikimet dietetike, mbrojtja ndaj infeksioneve dhe teknikat e duhura te administrimit te preparateve kunder anemise nga mungesa e Fe jane ne fokus te nderhyrjeve infermierore ne kete rast..</i></p>	fq. 588 - 590	Leksion 1 orë
	<p><b>Praktike 37:</b> Vlerësimi i shkallës së dehidrimit dhe frenimit të rritjes tek fëmijët dhe aplikimi i metodave te ushqyerjes.</p> <p><b>Praktike 38:</b> Studim rasti ne praktiken klinike te femijeve me hepatit. Implementimi i nje plani kujdesi.</p> <p><b>Praktike 39:</b> Administrim i transfuzionit të gjakut tek fëmijët me talasemi. Marrja e analizave: Hemokultura. Strisho gjaku.</p>	fq. 591 - 593	Leksion 1 orë
IV.	<p><b>Tema 40</b> - Problemet e sistemit hematologjik të fëmijëve: Kujdesi infermieror në hemofili. <i>Hemopatia kongenitale qe karakterizohet nga difekti i koagulimit te gjakut, ku roli i infermierit fokusohet ne nderhyrjet per ndalimin e hemorragjise vecanerisht administrimit te faktorit VIII. Fq 593-597</i></p> <p><b>Tema 41</b> - Konsiderata speciale në shëndetin e fëmijës: Çrregullime të hiperaktivitetit të vëmendjes. <i>ADHD, nje patologji qe ka lidhje me impulsivitetin dhe pavemendshmerine e femijeve qe ndikon ne demtimin e komunikimit verbal dhe marredhenieve sociale, performancen akademike, identifikon</i></p>	fq. 593 - 597	Leksion 1 orë
		fq. 598 - 599	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>nevojen per edukimin e femijeve me hyperaktivitet dhe permiresimit te tyre rreth vetvleresimit. Fq 598-599</i></p> <p><b>Tema 42</b> - Konsiderata speciale në shëndetin e fëmijës: Autizmi. Vonesa mendore</p> <p><i>Autizmi, nje semundje e zhvillimit te funksioneve te trurit me deficence te inteligjences dhe sjelljes thekson domosdoshmerine e edukimit rreth modifikimit te sjelljes, inkurajimit dhe referimit ne qendra qe ofrojne programe te specializuara. Vleresohen vonesat ne hapat e arritjeve motorike dhe gjuhesore nepermjet testit te inteligjences apo te Denverit qe jep informacione per zhvillimin e femijeve me vonesa mendore. Zgjedhja e programeve edukative ne klasat e edukimit special,terapia e te folurit dhe ergoterapia perbejne edhe trajtimin e ketyre femijeve. Fq 599-602.</i></p> <p><b>Praktike 40:</b> Aplikimi i metodave te ndalimit te hemorragjise dhe administrimit te terapise tek femijet me hemofili.</p> <p><b>Praktike 41:</b> Administrimi i testeve të inteligjencës IQ</p> <p><b>Praktike 42:</b> Studim rastesh ne praktiken klinike per femijet me autizem dhe vonese mendore. Implementimi i nje plani kujdesi</p>	<p><i>fq.599 - 602</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 6 orë</i></p>
KV.	<p><b>Tema 43</b> – Konsiderata speciale në shëndetin e fëmijës: Helmimi aksidental</p> <p><i>Helmimi aksidental kryesisht tek femijet e vegjel por edhe tek adoleshentet ka ne fokus te kujdesit infermieror njohjen e masave te sigurta per parandalimin e helmimeve si dhe administrimin e antidoteve sidomos ne helmimin nga medikamentet por edhe metodat qe paketojne absorbimin e substancave helmuese.</i></p> <p><b>Tema 44</b> - Konsiderata speciale në shëndetin e fëmijës: Abuzimi me fëmijët. Abuzimi me substancat</p> <p><i>Pershkruhen llojet e abuzimit ose keqtrajtimin te femijes ne dimensionin fizik, psikologjik, seksual dhe ekonomik dhe regjimet terapeutike ne forme te terapise se lojes, artit, modifikimit te sjelljes etj.Abuzimi me alkolin, duhanin, drograt si nje ceshtje sociale me pasoja ne shendetin fizik dhe mendor te femijeve ka ne fokus kontrollin per ndryshimet ne sjellje me qellim zbullimin e hershem te femijeve qe abuzojne dhe masat per trajtimin nga varesia kimike e ketyre substancave, menaxhimit akut te simptomave, masave rehabilituese dhe programeve te edukimit per parandalimin e tyre..</i></p> <p><b>Tema 45</b> -Konsiderata speciale në shëndetin e fëmijës: Anoreksia mentale. Bulimia.</p> <p><i>Sindrom qe karakterizohet nga deshira e madhe per te ngrenepor qe me pas shoqerohet me provokim te te vjelles kerkon nderhyrjet e nevojshme infermiore vecanerisht ne korrigjimin e raportit ushqimore, dietes dhe crregullimeve te identitetit personal te shkaktuar prej peshes trupore.</i></p> <p><b>Praktike 43:</b>Njohja dhe aplikimi i regjimit terapeutik (terapia e lojes, artit) per te zbuluar abuzimin, llojin e dhunes tek femijet</p> <p><b>Praktike 44:</b>Menaxhimi i helmimeve në popullatën pediatrike.Studim rasti. Abuzimi me alkolin, duhanin, drogat. Implementimi i nje plani kujdesi</p> <p><b>Praktike 45:</b>Teknikat e ushqyerjes parenterale</p>	<p><i>fq. 604 - 606</i></p> <p><i>fq. 607 - 610</i></p> <p><i>fq.610 - 614</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 6 orë</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

<b>FREKUENTIMI:</b>	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuar ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhe dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuar. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
<b>KONTROLLI I VAZHDUESHËM</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Kapitulli III = Patologjitë pediatrike	90 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Prezantim me gojë	Raportim rasti / Demonstrim procedure
	*Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një projekti klinik që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet më të shpeshta të patologjive pediatrike apo neonatale, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të patologjive. Gjithashtu do të realizojnë dhe 3 plane kujdesi, bazuar në një format të gatshëm, për asistencën shëndetsore të hasur në praktikë. Një pjesë e punimeve do të prezantohen dhe në PPT.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

**LITERATURA**

<b>Literatura bazë e detyruar</b>	"Kujdesi për Nënë dhe Fëmijën" MSc R.Lalo MSc R.Çerçizaj Prill 2012 FSHP –UV ISBN 978-99956-91-99-8.
<b>Literatura e rekomanduar</b>	1. Child Health Nursing' M.Hogan, J.White 2008 2. 'Maternity and Pediatric Nursing' Thompson, 2005 3. 'By the ages – behavior and development' K.Eileen Allen 2008 . 4. 'Pediatra infermiere' H.Jazo, 2005 5. 'Maternity and Pediatric Nursing' Thompson 2010

**VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS**

<b>Dispozita:</b>	<p>Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar.</p>
-------------------	---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**  
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.